

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6759
E mërkurë, 16 nëntor 2022
çmimi 0.40 €

Begaj kërkon nga Azerbajxhani njohjen e pavarësisë së Kosovës

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRASNIQI NË BRUKSEL: MARRËVESHJA PËRFUNDIMTARE KOSOVË - SERBI, ME NJOHJEN RECIPROKE NË QENDËR

FAQE 5



Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka nisur vizitën zyrtare në Belgjikë, ku ka zhvilluar takime të shumta, duke përfshirë edhe takimin me përfaqësuesin special të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi dhe Ballkanin Perëndimor,

Miroslav Lajçak. Krasniqi ka bërë me dije se emisarit Lajçak ia ka bërë të qartë qëndrimin e PDK-së për një marrëveshje përfundimtare Kosovë - Serbi, me njohjen reciproke në qendër dhe e cila garanton anëtarësimin e Kosovës në OKB

AKTUALE



AAK-ja KËRKON RITJE
TË PAGAVE PREJ 30-PËRQINDËSH
PËR SEKTORIN PUBLIK F.7

BORRELL: 21 NËNTORI NUK DUHET
TË NA GJEJË PA MARRËVESHJE
PËR TARGAT F.7

PROKURORIA SPECIALE
SHËNJESTRON NJË RAST TË RI
TË KODUAR "REFLEKTORI" F.7

EKONOMI



HOTI: BUXHETI PËR VITIN 2023
NË TERMA REALË ËSHTË
2.5 MILIARDË EUR F.8

ZKA-ja PARALAJMËRON AUDITIM
PËR KEK-un F.8

FILLON JAVA GLOBALE E
NDËRMARRËSISË ME DISKUTIM
PËR PROGRAMET E MBËSHTETJES
SË STARTUPEVE F.8

SPORT



KOSOVA SONTE PËRBALLET
ME ARMENINË F.10



KOSOVA FLE
MBI THËNGJILL,
POR IMPORTON
NGA JASHTË

FAQE 5



PETKOVIQI:
ZGJEDHJET
NË VERI, TË
DESTINUARA PËR
TË DËSHTUAR

FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Popullsia e botës arrin në 8 miliardë

NJU-JORK, 15 NËNTOR - Organizata e Kombeve të Bashkuara tha se popullsia e botës ka arritur në 8 miliardë, vetëm 11 vjet pasi ka kaluar 7-miliardëshin. Pas një rritjeje të shpejtë në mes të shekullit 20, rritja e popullsisë është duke u ngadalësuar, tha OKB-ja. Sipas saj, mund të duhen 15 vjet për të arritur në 9 miliardë.

OKB-ja ka njoftuar se nuk pret që shifra prej 10 miliardë

banorësh të arrihet deri në vitin 2080.

Numri i njerëzve në botë është vështirë të llogaritet me precizitet dhe OKB-ja pranon se të dhënat e saj mund të mos jenë të sakta për një ose dy vjet. Rritja më e madhe e popullsisë në 11 vjetët e fundit është shënuar në vendet me të ardhura mesatare, kryesisht në Azi. Ato janë shtuar për rreth 700 milionë njerëz që nga viti

2011.

India ka shtuar rreth 180 milionë njerëz dhe pritet ta kalojë Kinën si vendi më i populluar në botë vitin e ardhshëm.

Lindjet kanë qenë në rënie të vazhdueshme në Shtetet e Bashkuara, Evropë dhe Japoni. Arsyet për këtë janë të ndryshme - nga ndryshimi i mënyrës së jetesës deri te shqetësimet ekonomike.



ShBA-ja shkatërron një anije me "materiale shpërthyes" nga Irani

UASHINGTON, 15 NËNTOR - Marina amerikane tha të martën se ka shkatërruar një anije që po transportonte "materiale shpërthyes" nga Irani për rebelët Huthi në Jemen.

Anija, të cilën marina amerikane e kapi më 8 nëntor në Gjirin e Omanit, u fundos të dielën, tha Flota e Pestë e Shteteve të Bashkuara me bazë në Bahrej. "Anija dhe katër anëtarët e ekuipazhit të saj jemenas u kapën derisa po kalonin transit nga Irani përgjatë një rruge që historikisht përdoret për të trafikuar armë për rebelët Huthi në Jemen", thuhet në deklaratën e marinës amerikane.

Forcat amerikane zbuluan më shumë se 100 tonë plehra të uresë dhe mbi 70 tonë perklorat amoniumi - përbërës kyç për prodhimin e karburantit të



raketave dhe eksplozivëve, thuhet në deklaratë. "Kjo është një sasi masive e materialit shpërthyes, e

mjaftueshme për dhjetëra raketa balistike me rreze të mesme veprimi, varësisht madhësisë së

tyre", tha zëvendësadmirali amerikan Brad Cooper.

"Transferimi i paligjshëm i

ndihmës vdekjeprurëse nga Irani nuk kalon pa u vënë re", shtoi ai. Katër marinarët jemenas iu dorëzuan rojës bregdetare jemenase.

Lufta në Jemen ka shpërthyer në vitin 2014, kur rebelët Huthi, të mbështetur nga Irani, kanë pushtuar kryeqytetin Sana. Kjo ka bërë që një koalicion i udhëhequr nga Arabia Saudite të ndërhynte disa muaj më vonë për ta mbështetur Qeverinë e njohur ndërkombëtarisht të Jemenit.

Që atëherë lufta ka lënë të vrarë qindra mijëra njerëz dhe ka çuar vendin në prag të urisë. Një armëpushim i ndërmjetësuar nga Kombet e Bashkuara, që ka hyrë në fuqi në muajin prill, i ka zvogëluar armiqësitë, por ai armëpushim ka skaduar më 2 tetor dhe luftimet vazhdojnë.

Zelensky: Rusia shkatërroi infrastrukturën kritike në Herson



KIEV, 15 NËNTOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, tha se Rusia ka shkatërruar "të gjithë infrastrukturën kritike" në Herson-rajonin e rimarrë nga ushtria ukrainase javën e kaluar.

Zelensky tha se në Herson nuk ka energji elektrike, nuk ka komunikim dhe nuk ka televizion. Trupat ruse kanë shkatërruar gjithçka qëllimisht, tha ai. "Kjo është ajo që do të thotë flamuri rus: shkatërimi i plotë", tha Zelensky pasi vizitoi Hersonin e çliruar më 14 nëntor.

Çlirimi i Hersonit të premtën e kaluar ishte një nga sukseset më të mëdha të Ukrainës në luftën e saj kundër pushtimit rus.

Gjatë vizitës në Herson, Zelensky tha se çlirimi i qytetit është "fillimi i fundit të luftës". Presidenti i ShBA-së, Joe Biden, tha se rimarrja e këtij rajoni nga forcat ukrainase është një "fitore e rëndësishme". "Nuk mund të bëj asgjë tjetër veçse ta duartrokas guximin, vendosmërinë dhe kapacitetin e popullit ukrainas", tha Biden. Hersoni ka rënë nën kontrollin e

forcave ruse në mars - disa javë pasi presidenti rus, Vladimir Putin, ka dhënë urdhrin për pushtimin në shkallë të gjerë të Ukrainës.

Pas disa referendumeve të paligjshme që ka mbajtur në shtator, Rusia e ka aneksuar atë, së bashku me tri rajone të tjera ukrainase. Por, javët e fundit, Ukraina ka shënuar fitore të mëdha në fushëbetejë, duke i vënë forcat ruse nën presion.

Ato janë tërhequr të premtën nga Hersoni, ku më pas kanë hyrë trupat ukrainase.

Rusia sanksionon edhe 100 shtetas kanadezë

MOSKË, 15 NËNTOR - Rusia ka sanksionuar 100 qytetarë kanadezë, duke përfshirë yllin e Hollywoodit, Jim Carrey, në shenjë hakmarrjeje të sanksioneve të vendosura nga Otava për qytetarët rusë. Ministria e Jashtme ruse njoftoi

më 14 nëntor se ka vendosur sanksione ndaj qytetarëve kanadezë, përfshirë shkrimtaren e njohur Margaret Atwoodm, shkrimtarin dhe regjisorin David Bezmozgis dhe aktoren Kathrynne Winnick. Qytetarët kanadezë, që i janë

shtuar listës së sanksioneve, përfshijnë zyrtarë aktualë dhe ish-zyrtarë kanadezë, përfaqësues të institucioneve arsimore dhe figura të tjera. Në qershor Rusia sanksionoi 49 qytetarë kanadezë, duke ua pamundësuar hyrjen në Rusi.



Borrelli: 21 nëntori nuk duhet të na gjejë pa marrëveshje për targat

PRISHTINË, 15 NËNTOR - "Jemi duke u përballur me krizën më serioze në dhjetë vjetët e fundit", ka thënë shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell, duke komentuar tensionet në rritje midis Kosovës dhe Serbisë.

Borrelli ka thënë se të dyja palët duhet urgjentisht të tregojnë gatishmëri për uljen e tensioneve. Ai i bëri komentet në një konferencë për medie në Bruksel pas një takimi që zhvilluan ministrat e Jashtëm të BE-së për çështje që lidhen me Ballkanin Perëndimor. Tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë rritur prej se Qeveria e Kosovës ka nisur më 1 nëntor zbatimin e planit të saj për riregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe.

Këto makina, rreth 9 000 sosh, qarkullojnë kryesisht në veri të Kosovës, ku popullata shumicë është serbe dhe kontrollohet në masë të madhe nga Beogradi zyrtar.

Qeveria e Kosovës do që të gjitha makinat të riregjistrohen me targa RKS, apo Republika e Kosovës, por Serbia kundërshton, duke insistuar në targa neutrale ndaj statusit të Kosovës.



Si pasojë e tensioneve të rritura, serbët e veriut i kanë braktisur institucionet e Kosovës.

Borrelli ka thënë se 21 nëntori - dita kur, sipas planit të Qeverisë së Kosovës për riregjistrimin e makinave, pritet të nisë gjobitja e shoferëve me targa të paligjshme - nuk duhet t'i gjejë Kosovën dhe Serbinë pa një marrëveshje për targat.

Në të kundërtën, "do të kemi situatë të rrezikshme", ka thënë Borrelli, duke mos elaboruar më shumë.

Në BE disa diplomatë pranojnë se nuk janë të kënaqur me ecurinë e deritashme të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë dhe përgjegjësinë për ngecje dhe rritje të tensioneve ua

bartin dy vendeve.

Me ndërmjetësimin e BE-së, Kosova dhe Serbia janë në negociatë qysh në vitin 2011. Pritet kanë qenë që pas takimit të fundit midis kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, që është zhvilluar më 18 gusht në Bruksel, të ketë më shpesh takime të tilla së paku një

herë në muaj. Por, nga ajo kohë, nuk ka pasur asnjë.

BE-ja dhe ShBA-ja i kanë kërkuar Kosovës që ta shtyjë për dhjetë muaj zbatimin e planit për riregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe me qëllim shmangien e tensioneve. Qeveria e Kosovës, megjithatë, ka nisur zbatimin e tij më 1 nëntor.

Faza e parë e planit parasheh qortimin e shoferëve që vozisin makina me targa të paligjshme; e dyta parasheh gjoba prej 150 eurosh, në të tretën do të shpërndahen targa provueve. Me këtë plan pritet që nga 21 prilli i vitit të ardhshëm në komunikacion të lejohen vetëm makina me targa RKS.

Komuniteti ndërkombëtar, gjithashtu, i ka shtuar thirrjet për Kosovën që ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Për Asociacionin, Kosova dhe Serbia kanë arritur një marrëveshje në vitin 2013, por ajo nuk është zbatuar asnjëherë. Kurti thotë se në Kosovë nuk mund të ketë asociacion njëetnik, ndërsa Serbia kërkon që asociacioni të formohet dhe të ketë kompetenca ekzekutive.

Petkoviqi: Zgjedhjet në veri, të destinuara për të dështuar

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Shefi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviq, ka thënë se zgjedhjet e shpallura për katër komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës janë të destinuara të dështojnë.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, caktoi 18 dhjetorin datë për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në Mitrovicë të Veriut, Zvečan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Kryetarët e këtyre komunave dhanë dorëheqje më 5 nëntor në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për ta nisur procesin e riregjistrimit të makinave me targa të paligjshme serbe. Osmani tha se vendimi për shpalljen e zgjedhjeve është "detyrim kushtetues" që pason "aktin e dorëheqjes së katër kryetarëve të komunave".

Sipas Petkoviqit, "kjo është një përpjekje e re e Prishtinës për ta pushtuar veriun e Kosovës, duke u fshehur pas një lloj procesi zgjedhor". "Kjo është edhe një dëshmi se Prishtina asnjëherë nuk



ka dashur bashkëpunim institucional me serbët e Kosovës por, përkundrazi, është munduar ta zbatojë dhe rrumbullakojë idenë e saj për Shqipërinë e madhe dhe

t'i dëbojë serbët nga vatrën e tyre shekullore", tha Petkoviqi, duke mos ofruar asnjë provë që do t'i mbështeste këto pretendime. "Zgjedhjet për komunat serbe, pa

serbë dhe popullin serb, nuk kanë kuptim dhe, si të tilla, janë të destinuara për të dështuar", ka thënë Petkoviqi përmes një komunikate për medie.

Në një anketë që ka bërë "Radio Evropa e Lirë" me disa qytetarë në Mitrovicën e Veriut, më 11 nëntor, ata kanë thënë se nuk do të marrin pjesë në zgjedhjet e jashtëzakonshme.

Përveç kryetarëve të katër komunave, dorëheqje nga institucionet e Kosovës kanë dhënë edhe serbët të tjerë të veriut - nga niveli lokal deri në atë qendror.

Të mbështetur nga Beogradi zyrtar, ata kundërshtojnë planin e Qeverisë së Kosovës për riregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe.

Me këtë plan parashihet që makinat me targa të tilla të riregjistrohen me targa RKS, apo Republika e Kosovës deri më 21 prill të vitit të ardhshëm.

Serbia kundërshton, duke këmbëngulur në targa neutrale ndaj statusit të Kosovës.

Autoritetet e Kosovës kanë nisur zbatimin e planit më 1 nëntor, me gjithë thirrjet e komunitetit ndërkombëtar për ta shtyrë atë për shkak të rrezikut të tensioneve.

KOZ-ja fillon përgatitjet për zgjedhjet në veri, ndan 556 mijë e 482 euro

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka filluar përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të komunave në Mitrovicën e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe

Zvečan. Sipas njoftimit të KQZ-së, pas shpalljes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të komunave të lartcekura që do të mbahen më 18 dhjetor të këtij viti, ky komision ka mbajtur mbledhje për të filluar me

përgatitjet për organizimin e tyre.

Në këtë mbledhje KQZ-ja ka marrë vendim për miratimin e planit operacional për organizimin e zgjedhjeve. Ky institucion ka ndarë 556 mijë e 482 euro për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve.





Krasniqi në Bruksel: Marrëveshja përfundimtare Kosovë - Serbi, me njohjen reciproke në qendër

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka nisur vizitën zyrtare në Belgjikë, ku ka zhvilluar takime të shumta, duke përfshirë edhe takimin me përfaqësuesin special të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi dhe Ballkanin Perëndimor, Miroslav Lajçak. Krasniqi ka bërë me dije se emisarit Lajçak ia ka bërë të qartë qëndrimin e PDK-së për një marrëveshje përfundimtare Kosovë - Serbi, me njohjen reciproke në qendër dhe e cila garanton anëtarësimin e Kosovës në OKB

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

BRUKSEL, 15 NËNTOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka nisur vizitën e tij zyrtare në Belgjikë. Në ditën e parë të vizitës, Krasniqi ka zhvilluar takime me partitë liberale të Holandës dhe të Belgjikës në kuadër të forcimit të raporteve bilaterale partiake. "Në Holandë takova partitë VVD dhe D66, dy nga partitë më të mëdha që përbëjnë qeverinë e këtij shteti. Ndërkaq, në Belgjikë

takova përfaqësuesit e Open VLD, partisë që udhëheq qeverinë belge. Të tri këto parti janë anëtare të rëndësishme të Partisë Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën (ALDE), anëtare e së cilës synojmë të bëhemi edhe ne si PDK", ka thënë ai. Krasniqi ka theksuar se mbështetja e liberalëve të BE-së ndaj vizionit të ri të PDK-së dhe qëllimit kësaj partie për t'u bërë pjesë e familjes liberale, dhe roli si parti lidere e opozitës në Kosovë, ishin pjesë e

diskutimeve me këto subjekte politike. "Po ashtu, biseduam edhe për zhvillimet aktuale dhe aspiratat tona si vend drejt integritimeve euroatlantike. Fuqizimi i PDK-së në skenën politike evropiane është i nevojshëm dhe në shërbim të Republikës së Kosovës", ka theksuar ai. Krasniqi gjatë vizitës në Bruksel ka zhvilluar takim edhe me përfaqësuesin special të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi dhe Ballkanin Perëndimor, Miroslav Lajçak.

Kurti mori pjesë në Forumin Ekonomik Global Connect 2022


SHTUTGART, 15 NËNTOR - Në ditën e parë të qëndrimit të tij në Shtutgart të Gjermanisë, kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në ceremoninë hapëse të Forumit Ekonomik Global Connect 2022, ku mbajti edhe një fjalë rasti.

Ai i falënderoi organizatorët për ftesën dhe për mundësinë që i kanë dhënë Kosovës që të jetë pjesëmarrëse në këtë Forum. Në fjalën e tij, kryeministri Kurti foli për mundësitë që Kosova ofron për investitorët e huaj dhe vlerat që ndan me Bashkimin Evropian. Ai tha se vendi ynë ka një qeveri demokratike dhe institucione të qëndrueshme që përbëjnë bazë të favorshme për investitorë që synojnë investime të qëndrueshme dhe kthim të tyre. Si një nga përparësitë e Republikës së Kosovës, kryeministri Kurti e veçoi kapitalin njerëzor. Me 2/3 e popullatës nën moshën 35-

vjeçare, fuqi punëtore të talentuar dhe të motivuar dhe që flet gjuhë të huaja, Kosova paraqet një mundësi shumë të mirë për bizneset gjermane. Me këtë rast, ai u bëri ftesë përfaqësuesve të bizneseve që ta vizitojnë Kosovën.

Duke iu referuar raporteve ndërkombëtare si ai i Transparency International, Reporterët pa Kufij dhe Projekti i Drejtësisë Botërore dhe indikatorëve ekonomikë, kryeministri Kurti tha se qeverisja e mirë, sundimi i ligjit dhe rritja ekonomike janë prioritete të dëshmuara të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kryeministri Kurti, po ashtu, vizitoi edhe shtandin e Republikës së Kosovës në këtë forum dhe përshëndeti përfaqësuesit e KIESA-s dhe Unionit të Bizneseve. Global Connect është një forum ekonomik për eksport dhe ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve në Gjermani, të



cilat janë të interesuara për zgjerimin e veprimtarisë së tyre kryesisht jashtë vendit. Ai është forumi i vetëm i këtij formati në

Gjermani dhe ofron mundësinë e ndërlidhjes së afaristëve dhe krijimin e kontakteve të reja. Në kuadër të këtij forumi, Republika

e Kosovës ka shtandin e vet për t'i prezantuar mundësitë e saj për investitorët gjermanë dhe të tjerë.

Begaj kërkon nga Azerbajxhani njohjen e pavarësisë së Kosovës



TIRANË, 15 NËNTOR - Presidenti i Azerbajxhanit, Ilham Aliyev, ka qëndruar për një vizitë zyrtare në Shqipëri. Ai së pari ka takuar presidentin shqiptar Bajram Begaj, me të cilin ka folur për thellimin e raporteve dypalëshe. Gjatë fjalës së tij, Begaj ka kërkuar nga Aliyev njohjen e Kosovës prej Azerbajxhanit dhe mospengimin e saj në rrugëtimin drejt anëtarësimit në organizatat e rëndësishme ndërkombëtare. "Për sa i përket rajonit tonë, i shpreha presidentit mik Aliyev qëndrimin se Kosova është tejet e rëndësishme për Shqipërinë. Stabiliteti dhe përparimi demokratik i Kosovës është i

rëndësishëm jo vetëm për ne, por për qëndrueshmërinë dhe përparimin e të gjithë rajonit tonë. Ne e inkurajojmë Qeverinë e Azerbajxhanit që të mbështesë dhe mos pengojë anëtarësimin e Kosovës në organizma të ndryshëm ndërkombëtarë, si në Këshillin e Evropës apo njohjen e dokumenteve të udhëtimit të qytetarëve të Kosovës. Jo më pak i rëndësishëm është bashkëpunimi ndërparlamentar. Krijimi i Grupit Parlamentar të Miqësisë në mes të Shqipërisë dhe Azerbajxhanit duhet të ndiqet nga hapa të tjerë, që krijojnë mundësitë për shtim të bashkëpunimit mes dy parlamenteve tona", ka thënë

Begaj.

Ndërsa presidenti Aliyev ka kërkuar nga Shqipëria që t'i mbështesë kërkesat e Azerbajxhanit për sanksione ndaj Armenisë për atë që është duke ndodhur në rajonin e Nagorni Karabakh.

Aliyev ka përmendur edhe faktin se Shqipëria është një rrugë kalimi për gazin azer në drejtim të Evropës. "Deri më 2027 do ta dyfishojmë furnizimin me gaz për Evropën dhe ky gaz do të kalojë përmes Shqipërisë", ka thënë Aliyev duke shtuar se Azerbajxhani ka sasi të mëdha gazi dhe mund të dyfishohet sasia e gazit që transportohet nga vendi i tij në drejtim të Evropës.

"Bashkë diskutuam për zhvillimet e fundit në pjesën veriore të Kosovës, situatë për të cilën nevojiten veprime të përgjegjshme politike. Emisari Lajçak i ritheksova qëndrimin për një marrëveshje përfundimtare Kosovë - Serbi, me njohjen reciproke në qendër dhe e cila garanton anëtarësimin e Kosovës në OKB. Integrimi euroatlantik i Kosovës është rruga e vetme përpara, për të cilën unë dhe Partia Demokratike e Kosovës mbesim thellësisht të përkushtuar", ka deklaruar Krasniqi.

Lideri i PDK-së në ditën e dytë të vizitës zyrtare në Bruksel, bashkë me eurodeputetin Ilhan Kyuchyuk, i cili është edhe ko-president i ALDE-s, kishin një mëngjes pune me disa eurodeputetë liberalë nga vende të ndryshme të Bashkimit

Evropian.

Më pas, në takime të ndara, Krasniqi ka takuar edhe Felix Mittermayer nga partia austriake NEOS dhe eurodeputetin Malik Azmani nga partia holandeze VVD. "Rrjetëzimi i PDK-së me liberalët e Bashkimit Evropian, procesi i reformave partiake, si dhe sigurimi i mbështetjes së tyre drejt synimit tonë për t'u bërë pjesë e familjes liberale, ishin disa nga temat për të cilat u pajtuam ta përqendrojmë komunikimin e mëtutjeshëm. Me partnerë dhe miq të tillë, fuqizimi i PDK-së në skenën politike evropiane është i sigurt dhe do ta ndihmojë aspiratën e Kosovës për integrim", ka theksuar Krasniqi.

Ai ka takuar edhe eurodeputetin nga Suedia, Abir Al-Sahlani, të cilën e ka përgëzuar për punën e saj të palodhshme dhe konsistente në mbrojtje të

kauzave të rëndësishme. "Eurodeputeten Al-Sahlani e falënderova edhe për mbështetjen e saj për aspiratën e PDK-së për anëtarësim në ALDE. Po ashtu, e inkurajova ta vazhdojë aktivizmin e saj politik në mbështetje të grave iraniane dhe për fuqizimin e barazisë gjinore kudo në botë", ka deklaruar Krasniqi.

Lideri i PDK-së pas Brukselit do të zhvillojë vizitë zyrtare edhe në Uashington. "Kosova, situata aktuale, sfidat dhe rrugët tona përpara - do të jenë tema të diskutimeve në dy kryeqendrat e globit. Kohët e vështira kërkojnë bashkëpunim me partnerët e vërtetë, të besueshëm dhe strategjikë. Me miq të cilët ia duan të mirën Kosovës, popullit tonë dhe që mbajnë gjithmonë dyert hapur për ne", ka bërë me dije Krasniqi.



Kosova fle mbi thëngjill, por importon nga jashtë



PRISHTINË, 15 NËNTOR - Rreth 6 milionë euro është vlera e thëngjillit të përpunuar që bizneset në Kosovë kanë importuar në dy vjetët e fundit nga shtetet fqinje dhe të tjera, tregojnë të dhënat e Doganave të Kosovës.

Importi ka arritur këtë vlerë me gjithë faktin se Kosova zë vendin e pestë në botë për rezerva të thëngjillit. Por, problemi duket se qëndron te fakti se “Kosova Thëngjilli” - kompania e vetme e licencuar për shitjen e thëngjillit të përpunuar në Kosovë - nuk e ka vazhdimisht këtë lëndë, ndërsa kërkesat për të janë në rritje tash e sa kohë. “Kosova Thëngjilli” është shoqëri aksionare, e krijuar në vitin 2013, në kuadër të Korporatës Energjetike të Kosovës - KEK. Ajo e blen thëngjillin nga KEK-u, e përpunon dhe më pas e shet. Kontrata mes KEK-ut dhe “Kosova Thëngjillit” përditësohet çdo tre vjet.

Afati i kontratës aktuale pritet të skadojë muajin e ardhshëm, por nga KEK-u nuk tregojnë nëse ajo do të vazhdohet ose jo. “Sasia e përcaktuar në kontratë është shpërndarë në tërësi... Për rrjedhojë, kontrata është përbushur plotësisht”, thuhet në një deklaratë me shkrim nga KEK-u dërguar “Radios Evropa e Lirë”.

Për tre vjet “Kosova Thëngjilli” blen nga KEK-u rreth 600 mijë tonë thëngjill. “Ne e blejmë thëngjillin nga KEK-u, e

përpunojmë, e terim, e sitim dhe e qesim në treg... ua shesim konsumatorëve, kompanive të ndryshme vendore dhe jashtë Kosovës”, shpjegon për “Radion Evropa e Lirë”, Enver Sadiku, një prej punëtorëve të kompanisë. Sipas tij, sasia e thëngjillit të kontraktuar para tre vjetësh nga KEK-u është shpenzuar rreth tre muaj më parë për shkak të kërkesave të mëdha. “Vetëm Korporata Energjetike e Maqedonisë [së Veriut], nga muaji tetor i vitit të kaluar deri në muajin maj të këtij viti, ka marrë [prej nesh] 120 mijë tonë”, thotë Sadiku.

Thëngjilli i përpunuar përdoret për disa qëllime, përfshirë edhe ngrohjen, edhe pse ndikon në ndotjen e ajrit kur digjet. Kërkesat për këtë produkt thuhet se janë rritur gjetkë për shkak të krizës energjetike që ka përfshirë Evropën.

Qeveria e Kosovës ka paralajmëruar, po ashtu, mungesa të energjisë elektrike gjatë dimrit dhe u ka bërë thirrje qytetarëve që të gjejnë alternativa për ngrohje. Ajo madje ka shfuqizuar një vendim të vitit 2018, në bazë të të cilit shitja e thëngjillit nga KEK-u ka qenë e ndaluar.

KEK-u tashmë ka shpallur një ankand për të dhënë në dispozicion të nxjerrjes dhe shitjes rreth 100 mijë tonë thëngjill.

Nga kjo kompani thonë se ankandi pritet të finalizohet me

nënshkrim të kontratës “shumë shpejt”, por nuk japin detaje se ku synohet të destinohet kjo sasi e thëngjillit.

Kompanitë private blejnë thëngjill në Serbi

Mungesa e thëngjillit të përpunuar në Kosovë ka bërë që kompanitë private në vend t’ua mësyjnë tregjeve rajonale. Nga kompania “Silcapor”, e cila gjendet në Kaçanik - pjesa jugore e Kosovës - thonë se me thëngjill të përpunuar furnizohen nga Serbia. Kjo kompani prodhon blloqe të betonit, ndërsa thëngjillin e përpunuar, përkatësisht të terur, e përdor për pjekjen e blloqeve.

Menaxheri Vedat Kalisi thotë për “Radion Evropa e Lirë” se kompania brenda muajit importon deri në 400 tonë thëngjill të terur. “Vitin e kaluar këtë produkt e kam blerë në Kosovë, në kompaninë ‘Kosova Thëngjill’, me çmim prej 60 eurosh për ton. Tash nga Serbia, një ton thëngjill, së bashku me transport, më kushton rreth 200 euro”, thotë Kalisi.

Me thëngjill të përpunuar nga Serbia furnizohet edhe kompania “Abi & Elif” nga qyteti i Prizrenit. Kjo kompani merret me përpunimin e pemëve dhe perimeve. Thëngjillin e shfrytëzon për prodhimin e avullit, i cili më pas përdoret për prodhimin e produkteve të

ndryshme - nga turshitë deri tek ajvari. “Në muaj ne shpenzojmë deri në 100 tonë [thëngjill të përpunuar]”, thotë menaxheri i kompanisë, Abedin Loyna. “Vazhdimisht kemi blerë prej ‘Kosova Thëngjillit’, por që dy vjet jo, sepse nuk ka vazhdimisht... Edhe cilësia nuk është në nivel të duhur”, shton ai. Sipas tij, nëse “Kosova Thëngjilli” do të kishte mjaftueshëm thëngjill të përpunuar dhe me cilësi të lartë, kompania “Abi & Elif” do të kishte leverdi të furnizohej prej saj edhe për shkak të afërsisë, edhe për shkak të çmimit. Ai thotë se çmimi në Serbi është “dyfish më i lartë” - deri në 120 euro për ton.

Leci: KEK-u nuk po e shfrytëzon momentin

Hamit Leci, ish-punëtor i kompanisë “Kosova Thëngjilli”, thotë se mosshitja e thëngjillit nga KEK-u është një gjë “absurde”. Sipas tij, kriza aktuale energjetike është mundësi adekuate për KEK-un që të gjejë tregje të reja, e rrjedhimisht të rrisë të hyrat financiare.

Kriza energjetike ka nisur vitin e kaluar me rritjen e çmimeve të energjisë si pasojë e pandemisë së koronavirusit. Ajo është thelluar edhe më, pasi Rusia - një ndër furnizueset më të mëdha me gaz në botë - ka nisur pushtimin e Ukrainës në fund të shkurtit. “Ne i kemi të gjitha kushtet për t’i shfrytëzuar krizat,

sepse kriza në Ukrainë nuk ndodh gjithmonë. Por, këta nuk po e shfrytëzojnë momentin”, thotë Leci, tani pensionist. Sipas tij, “Kosova fle në thëngjill e nuk ka për të shitur”.

Sa ka thëngjill Kosova?

Kosova ka më shumë se 10 miliardë tonë thëngjill dhe, si e tillë, është vendi i pestë në botë për nga sasia e këtij burimi. Basenet më të rëndësishme thëngjillmbajtëse njihen si baseni i Kosovës, i Dukagjinit dhe i Drenicës.

Sasia më e madhe e këtij produkti shfrytëzohet nga termocentralet e KEK-ut për prodhimin e energjisë elektrike. Sipas të dhënave të KEK-ut, nga viti 1922, kur ka filluar nxjerrja e thëngjillit, deri në dhjetor të vitit 2015 nga baseni i Kosovës janë nxjerrë gjithsej 339 milionë tonë thëngjill. Për prodhim të energjisë elektrike, KEK-u shfrytëzon mesatarisht 8 milionë tonë thëngjill në vit.

Të dhënat e Doganave të Kosovës tregojnë se gjatë këtij viti në Kosovë është importuar thëngjill në vlerë prej më shumë se 1.5 milion eurosh nga shtetet e rajonit të Ballkanit, Turqia dhe Polonia. Vitin e kaluar, ndërkaq, është importuar thëngjill në vlerë prej 4.3 milionë eurosh. Sasia më e madhe në atë periudhë është importuar nga Mali i Zi, Rusia dhe Serbia.

AAK-ja kërkon rritje të pagave prej 30-përqindësh për sektorin publik

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka kërkuar që të ketë rritje të pagave prej 30-përqindësh për punëtorët e sektorit publik.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, në konferencën për medie ka theksuar se Qeveria e Kosovës ka gënjyer 80 mijë zyrtarë publikë, duke mos e përfshirë Projektligjin për Paga në Buxhetin për vitin 2023. "Qeveria e Kosovës i ka gënjyer të gjithë zyrtarët publikë, duke u thënë se do ta sjellë Projektligjin e Pagave dhe duke mos vendosur në zbatim Ligjin e Pagave. E kanë luajtur një lojë të ulët, duke i mashtruar rreth 80 mijë punëtorë të zyrtarëve publikë tash e sa kohë. Nga analizimi i buxhetit shohim se as që bëhet fjalë për rritjen e pagave në sektorin publik", është shprehur Tahiri. "Kërkesë e jona

për qeverinë është një amendament, ku do të kërkohej rritja lineare e pagave për së paku 30 për qind, deri në miratim të Ligjit të Pagave, përpos zyrtarëve që janë të zgjedhur politikisht", ka shtuar ai.

Ndërkaq deputeti Pal Lekaj ka shtuar se në buxhetin për vitin 2023 nuk parashihet askund rritja e pagave. "Asnjë ngritje e pagave nuk është, nuk ka ngritje të pagave për shërbyesit shëndetësorë, për infermierët, për mësimdhënësit, për policinë e për asnjë kategori. Me amendamentin e propozuar do ta kooperojmë rritjen e pagave prej 30-përqindësh për të gjithë punëtorët e sektorit publik. Përndryshe nëse qeveria prapë nuk vepron, po e shihni se në çfarë gjendje jemi, e shohim me çfarë inflacioni po përballemi. Ky propozim është i përballueshëm për qeverinë, andaj shpresoj se do të hasim në mirëkuptim", ka thënë Lekaj.



Konjufca takon një delegacion nga Kongresi amerikan, diskutojnë për shërbimet e bibliotekës dhe arkivimit

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, të martën ka pritur në takim një delegacion nga Komisioni i Partneritetit për Demokraci (HDP) i Kongresit të ShBA-së për të diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit mes dy palëve lidhur me shërbimet e bibliotekës dhe arkivimit.

Në këtë takim ishin të pranishëm Mike Bishop, ish-kongresist nga Partia Republikane, Derek Luyten, drejtor ekzekutiv i HDP-së, Kimberly Ferguson, specialiste për menaxhimin e Sistemit Informativ Legjislativ në Bibliotekën e Kongresit, Sarah Garding, analiste për Çështje Evropiane në Shërbimin e Kërkimit të Kongresit (CRS) dhe Kristen Sample, drejtoreshë e përgjithshme e qeverisjes në Zyrën Qendrore të Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) në Uashington. "Në takim u shkëmbyen pikëpamje rreth mënyrave konkrete të bashkëpunimit ndërmjet HDP-së



dhe Kuvendit, me fokus mbështetjen për ngritjen e Institutit Parlamentar si dhe zhvillimin e shërbimeve të bibliotekës dhe arkivit të legjislativ", thuhet në komunikatën e Kuvendit të

Kosovës. Sipas kësaj komunikate, gjatë këtij takimi Konjufca e falënderoi ShBA-në për mbështetjen që i ofron Kosovës, duke shtuar se "miqësia e dëshmuar, aleanca strategjike dhe partneriteti shembullor ndërmjet

popujve dhe shteteve tona mbeten të palëkundura". Të njëjten e kaluar HDP-ja bëri me dije se këtë javë do të bashkëpunojë me Parlamentin e Kosovës lidhur me metodat që përmirësojnë llogaridhënien dhe profesiona-

lizmin e legjislaturës". "Partneriteti për Demokraci në Dhomën e Përfaqësuesve po punon ngushtë këtë javë me Parlamentin e Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me kërkimin dhe arkivimin - elemente kritike për llogaridhënien dhe profesionalizmin e legjislaturës", ka shkruar HDP-ja në "Twitter".

Ndërkohë, drejtori ekzekutiv i HDP-së ka shkruar të hënën në "Twitter" se problemet e kërkimit, arkivimit dhe menaxhimit të të dhënave nuk duhen të lihen anash. "Të konsideruara nga disa si çështje të dorës së dytë, këto janë çështje kritike për llogaridhënien dhe transparencën e institucioneve", ka shkruar ai. Sipas komunikatës së lëshuar nga Kuvendi i Kosovës, të dyja palët u pajtuan që ta zgjerojnë bashkëpunimin dhe t'i shkëmbejnë përvojat "në dobi të ngritjes së efikasitetit dhe funksionalitetit të përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës".

Prokuroria Speciale shënjestron një rast të ri të koduar "Reflektori"

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj, ka mbajtur të martën takimin e radhës me ekipin e përbashkët për përzgjedhjen dhe shënjestrimin e krimeve të rënda, ku kanë shënjestruar një rast të ri me

njëmbëdhjetë persona. Prokuroria Speciale ka njoftuar se rasti i shënjestruar është i koduar me emrin "Reflektori", ku janë të përfshirë njëmbëdhjetë persona për veprën penale "Blerja, posedimi, shpëlarja dhe shitja e paautorizuar e

narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge" nga neni 267, paragrafi 2, lidhur me nenin 275, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i KPRK-së, si dhe për veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve" nga neni 366, paragrafi 1 i KPRK-së.



Hoti: Buxheti për vitin 2023 në terma realë është 2.5 miliardë euro

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Ish-ministri i Financave, Avdullah Hoti, ka theksuar se për shkak të inflacionit prej rreth 20-përqindësh për produkte të konsumit bazik, buxheti nominal për vitin 2023 prej 3.2 miliardë eurosh është, në fakt, rreth 2.5 miliardë euro në terma realë. "Rrjedhimisht, ky buxhet në terma realë është më i ulët se

në vitin 2022 për së paku 300 milionë euro (sivjet ka qenë 2.8 miliardë euro). Krahasojeni vetë sasinë e mallrave që keni blerë vitin e kaluar me 100 euro, me sasinë e mallrave që mund të blini sivjet me ato 100 euro. Do të vini në këtë përfundim", ka shkruar Hoti në "Facebook". Më 29 tetor qeveria ka miratuar Projektligjin për Buxhetin e

Republikës së Kosovës për vitin 2023 në vlerë 3 miliardë e 212 milionë euro.

Kryeministri Albin Kurti pati theksuar se duke punuar maksimalisht dhe me nder, përmes ekzekutimit të këtij buxheti, do të angazhohen për t'i avancuar të gjitha aspektet që ndikojnë në jetën e qytetarëve të Kosovës.



Fillon Java Globale e Ndërmarrësisë me diskutim për programet e mbështetjes së startupeve



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Në ditën e parë të aktiviteteve të organizuara në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar një diskutim lidhur me programet e mbështetjes së startupeve me një panel të përbërë nga përfaqësues të institucioneve financiare ndërkombëtare, shoqërisë civile dhe të sektorit privat, e cila nxiti një diskutim interaktiv me të rinjtë të interesuar për më shumë informata rreth programeve ekzistuese.

Duke i hapur zyrtarisht aktivitetet e Odës Amerikane në shënim të Javës Globale të Ndërmarrësisë, drejtori ekzekutiv i kësaj organizate, Arian Zeka, ka thënë se për shkak

të rëndësisë që i kushton Oda Amerikane promovimit të ndërmarrësisë, ka qenë pjesë e këtyre aktiviteteve që kanë shënuar këtë javë për një dekadë të plotë. Në Kosovë këto aktivitete kanë për nikoqire nacionale Qendrën e Inovacionit të Kosovës (ICK).

Ai ka thënë se aktivitetet pesëditore të Odës Amerikane do të fokusohen në temat e sivjetme të përcaktuara nga Rrjeti Global i Ndërmarrësisë (GEN) e që janë ekosistemet, edukimi, gjithëpërfshirja dhe politikat.

Dajana Berisha, drejtoreshë ekzekutive e Forumit për Iniciativa Qytetare (FIQ), ka folur për rëndësinë e përkrahjes së të rinjve që kanë ide biznesi, pavarësisht nëse ato nisma ia dalin si të suksesshme ose dështojnë përgjatë rrugës, duke

theksuar në veçanti ndërmarrjet sociale. Sipas saj, nëse qeveria e mbështet sektorin e ndërmarrësisë shanset janë të mëdha për zhvillim, por procedurat burokratike që i përcjellin këto skema mund të shkaktojnë vonesa në disbursimin e përkrahjes monetare.

Krejt në fund udhëheqësja e FIQ tha se organizata që ajo drejton ka vendosur fokusin në mbështetjen e startupeve që kanë për ide aktivitetet digjitale dhe ato të gjelbra, ose të kujdesit për mjedisin.

Leonora Kusari nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) ka folur për programet që ata ofrojnë për ndërmarrësit e rinj, me theks në programin Star Venture, i cili, përveç asistencës teknike për zhvillim të biznesit, ofron edhe

ekspertizë për zgjerimin në tregjet ndërkombëtare. Ajo ka theksuar se asistenca që u ofrohet ndërmarrësve ka të bëjë edhe me qasjen në fondet investive.

Kusari ka shtuar se falë mbulueshmërisë së rrezikut financiar që do të bëhet nga BERZh-i, për herë të parë një bankë komerciale, BPB, do të nisë dhënie e kredive për startupe.

Më herët banka TEB, falë përkrahjes nga BERZh-i, ka pasur linja të veçanta financimi për ndërmarrjet në pronësi të grave. Kusari ka theksuar se për realizimin e një ideje të biznesit, përveç interesimit fillestar, është me rëndësi që të rinjtë të bëjnë edhe analizë ose hulumtim të hollësishëm të tregut.

Pronari i kompanisë "Frutex", Shaqir Palushi, ka folur për hapat

që të rinjtë duhet t'i ndërmarrin për të krijuar një biznes të suksesshëm. Gjithashtu, ai foli për ato që i konsideroi si aspekte të rëndësishme për ndërmarrësi, si koha, orientimi në nevojat e tregut, por edhe egoja.

Palushi i ka inkurajuar të rinjtë që aspirojnë për ndërmarrësi që t'i marrin parasysh këshillat e të tjerëve, duke theksuar se pasi të kenë kaluar nëpër këta hapa, duhet të drejtohen në adresat e duhura për sigurim të financimit, përfshirë edhe garën për ide të bizneseve "Golden Idea", të cilën e ka përkrahur financiarisht "Fondacioni Golden Eagle" e të cilën e ka realizuar televizioni ATV. Ai sqaroi se qëllimi i kësaj iniciative ka qenë mbështetja e të rinjve të cilët kanë ide biznesi, por kanë vështirësi në qasjen në financa për realizimin e atyre ideve.

ZKA-ja paralajmëron auditim për KEK-un

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Në mbledhjen e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, kryesuar nga kryetarja Hykmete Bajrami, u shqyrtua plani vjetor i auditimit për sezonin 2022-2023. Me këtë rast, auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, gjatë prezantimit të këtij plani, ka thënë se Zyra

Kombëtare e Auditimit planifikon që gjatë kësaj periudhe të auditojë 134 raporte të auditimit, ndërsa shpalosi ato në detaje. Spanca, mes të tjerash, ka thënë se ZKA-ja mund të realizojë këtë detyrë në mënyrë efikase. Sipas saj, do të jenë edhe 11 auditime financiare të pajtueshmërisë,

duke shtuar se do të ketë auditime të komunave, fondeve të donatorëve, ndërmarrje publike etj. Mirëpo, sipas saj, gjatë kësaj periudhe do të auditohet për herë të parë edhe KEK-u. Plani vjetor i auditimit për sezonin 2022-2023 mori mbështetjen e anëtarëve të komisionit.



Orhan Pamuk: Dashuria dhe politika në kohën e murtajës



Nga Simonetta FIORI

Vetëm një shkrimtar si Orhan Pamuk, mund të shkruante romanin e madh politik të "murtajës" bashkëkohore. Jemi në Minger, një ishull imagjinar përgjatë rrugës midis Stambollit dhe Aleksandrisë në Egjipt. Ngjarjet zhvillohen midis sulltanëve, pashallarëve, burokratëve dhe princësive, në graham e fundit të Perandorisë Osmane, të tronditur nga Murtaja e Zezë.

Por duket sikur ato ngjarje të viteve të para të shekullit të kaluar flasin për ne, për regjimet autoritare dhe për demokracitë tona të brishta. Ndoshta sepse "qendra sekrete" në librin "Netët e murtajës", i sapobotuar në Itali nga Einaudi, merret me lidhjet e shkurtra midis të mundshmes dhe së vërtetës, midis trillimit letrar dhe të vërtetës historike, midis shpikjes narrative të projektuara në një epokë të largët dhe evokimit të vazhdueshëm për të pasur një referencë ndaj ngjarjeve aktuale, të karakterizuara nga pandemia, karantinat dhe tërmetet në gjeografinë politike.

"Arti i romanit, bazohet në aftësinë për të treguar historitë tona, sikur të ishin të tjerëve, dhe për të treguar historitë e të tjerëve sikur të ishin tonat" - thotë në një rast një nga personazhet e Pamuk. Largimet dhe mohimet, kufizimet dhe izolimi, rebelimet, kulmet e autoritarizmit, burokracitë, radikalizmi fetar dhe nacionalist. Dhe pastaj është frika, ko sëmundja e shpirtit që rrëshqet deri në marrëdhëniet më intime, në familje, madje edhe në dhomën e gjumit. Ai kishte menduar prej vitesh të shkruante një libër mbi

murtajën, dhe kjo shpjegon gjithashtu edhe volumin e madh të romanit (mbi 700 faqe), i cili nuk mund të ishte një fryt i nxituar i pandemisë së fundit.

Mes kaq shumë fatkeqësive, koronavirusi i dha atij gjithashtu një përvojë që as Defo, Manxoni dhe as Kamy - tre romancierët e mëdhenj të murtajës - nuk e kishin përjetuar drejtpërdrejt. "Gjatë bllokimit, unë mësova jo vetëm se çfarë është frika, por mësova edhe ta përshkruaj, t'i jap një formë narrative".

Si ju lindi ideja të shkruani një roman mbi murtajën, përpara se ajo të shfaqej në jetën tonë? Kam nisur të mendoj për të që 45 vjet më parë. Ideja ishte të shkruaja një rrëfim historik mbi epideminë që preku Perandorinë Osmane në vitet e fundit të ekzistencës. Tema qendrore do të ishte frika nga vdekja, me të cilën ndërgjegjja perëndimore e lidh zbulimin e vetë ekzistencës së individit.

Pra një reflektim me një shije më filozofike...

Po, por më pas doja ta kombinoja me një temë tjetër, i frymëzuar nga vepra e Eduard Said, Orientalizmi, e cila është një analizë e fortë e mënyrës së shtrembëruar përmes të cilit Perëndimi e ka parë Lindjen e Mesme. Isha veçanërisht i fiksuar pas fatalizmi që do të karakterizonte sjelljen e turqve myslimanë përballë epidemisë: sipas klišesë orientaliste, ata do të rrinin e shikonin pa bërë asgjë, sepse Zoti e ka shkruar datën e vdekjes në ballin e të gjithëve. Ai e kupton se çfarë mendimesh rrotulloheshin në kokën time...

Pra kur u përhap Covid-19, e dinit tashmë se çfarë mund të ndodhte

në Turqi...

Në fakt, unë nisa ta shkruaj librin para shfaqjes së koronavirusit. Saktësisht 5 vjet e gjysmë më parë. Mendova se ishte koha e duhur. Pasi e kisha parë qeverinë e Erdoganit të zhvendosej në një terren gjithnjë e më shumë represiv: virusi dhe masat kufizuese për ta luftuar atë, do të kishin qenë një alegori e fuqishme e autoritarizmit në rritje të regjimit turk. Asokohe murtaja ishte vetëm një metaforë.

Më pas pushoi së qeni një metaforë dhe hyri në jetën tuaj... Në atë moment, shpërtheu kaosi. Miqtë që deri atëherë më kishin dekurajuar - "Çfarë roman i mërziqshëm mbi epideminë dhe karantinën, e kush do ta lexojë?" - filluan të më telefononin: "Sipas tyre unë isha njeriu më me fat në botë. Për të mos përmendur presionin nga botuesit e mi: I dashur Orhan, a e ke mbaruar librin? Kur do të na e dorëzosh?"

Si u ndjetë?

Para ndjesi të përziera. Nga njëra anë, nuk mund ta konsideroja veten me fat: Një nga viktimat e para të koronavirusit në Stamboll, ishte teza ime që jetonte pak blloqe larg meje. Një figurë shumë e rëndësishme për formimin tim artistik. Nga ana tjetër isha i gëzuar. Pasi po shkruaja një roman historik për një murtajë të rënë në vitin 1901, dhe në të njëjtën kohë po shkruaja për të sotmen. Një gjendje krijuese tipike post-moderne.

A e ndryshoi këndvështrimin tuaj përjetimi i tragjedisë së Covid-19? Po, rrënjësisht. Unë kisha shkruar tashmë shumë faqe. Por duke u mbështetur në leximin e librave të tjerë. E kuptova se në versionin e

parë të rrëfimit nuk kishte frikë. Pra mungonte frika ime: unë isha 68 vjeç, kisha frikë për jetën time dhe atë të të tjerëve. Por personazhet e mi nuk ishin aq të frikësuar nga murtaja sa unë nga koronavirusi. Prandaj u detyrova të bëj shumë ndryshime. Mua më duket se asnjë nga rrëfimtaret e dikurshëm të murtajës, nuk e ka përshkruar ndonjëherë këndvështrimin e tij. Ndërkohë ju flisni mbi epideminë në nivelin politik dhe shtetëror, pra për formimin e një burokracie të madhe që është ngritur rreth virusit: mjekë, farmacistë, ushtarë, ministra, autoritete fetare, pashallëqe...

Kjo do të jetë klasa e re sunduese e Mingerit, ku shpërthen një revoltë nacionaliste dhe lind një shtet i ri...

E përse zgjodhët këtë këndvështrim?

Kur kuptova që po shkruaja një roman mbi murtajën dhe politikën, desha të fokusohesha tek mekanizmat e ndërtimit të një kombi të ri. Nuk ka rëndësi nëse flasim për Turqinë, Shqipërinë, Malin e Zi apo Mingerin. Dhe së bashku me lindjen e një kombi të ri, më interesonte të tregoja kompleksin e mitografive dhe legjendave që legjitimojnë sovranët e rinj. Erik Hobsbaum i kushtoi këtij kompleksi librin e tij të famshëm "Shpikja e traditës". Është një fe e re laike, e cila pa bekimin e Zotit duhet të motivojë një komunitet.

Në këtë roman identifikohet qartë figura e autoritarit Abdyl Hamit, sulltani pan-islamk të Perandorisë Osmane, në një analogji me Erdoganin... Analogjia vlen vetëm pjesërisht.

Sulltani ishte shumë më i perëndimor se sa sot Erdogani. Ai e donte operën, fliste frëngjisht, lexonte me shumë pasion romane triller. Unë nuk e përfytyroj dot Erdoganin të lexojë Sherlock Holmsin! Abyl Hamiti shpiku islam politik, dhe e përdori atë për të shantazhuar Evropën. Por Erdogan beson më shumë se ai në shenjtërinë e Islamit.

Por a mendoni se trashëgimia laike dhe pro-perëndimore e Ataturkut, është një trashëgimi e fituar përgjithmonë? Apo rrezikon të zhbëhet nga ai që është quajtur "Uragani Erdogan"?

Unë besoj se trashëgimia e Ataturkut ka pësuar dëme serioze. Simboli më i qartë i traditës së tij përfaqësohet nga Hagia Sophia, një monument madhështor bizantin në Stamboll, i shndërruar falë Ataturkut nga një xhami osmane në një muze - një nderim për Perëndimin - dhe që tani me vendimin e Erdoganit është bërë sërish një vend adhurimi për myslimanët. Për kritikën që kam shprehur ndaj vendimit të qeverisë, kam pasur shumë sulme. Por në aspekte të tjera mund të them se laicizmi i Ataturkut është një traditë me rrënjë të thella në Turqi.

Për këtë libër ju jeni paditur në gjykatë me akuzën e fyerjes së Ataturkut...

Është një çështje shumë e ndërlikuar, madje paradoksale. Më thirrën nga prokuroria e Stambollit dhe më thanë: "Zoti Pamuk, në romanin tuaj ju keni dashur të talleni me babain e kombit, Mustafa Kemal Ataturk. Jo zotëri, unë i hedh poshtë të gjitha akuzat tuaja. Por ne kemi marrë shumë letra ankesash, që të gjitha me të njëjtën akuzë: ju keni ofenduar kujtimin e heroit tonë kombëtar. Jo, zoti prokuror, nuk ka qenë kurrë synimi im të fyej Ataturkun. Më tregoni në cilën faqe të romanit e kam bërë këtë?". Në atë moment avokati nuk dinte se çfarë të bënte.

Dhe si përfundoi kjo çështje?

Çështja i është referuar një gjykatë më të lartë në sistemin gjyqësor turk. Por sipas avokatit tim, ajo është bërë pjesë e labirintit të Ministrisë së Drejtësisë, e cila nuk di më çfarë të bëjë me të.

Një histori surreale...

Një histori që do t'i kishte pëlqyer Franc Kafkës. Duhet të ketë ardhur një urdhër nga lart, kushedi nga kush: Çfarë mund të bëjmë për ta goditur Pamuk? Atëherë, le të ngremë akuzën për fyerjen e Ataturkut. Besoj se edhe këtë herë më shpëtoi nga burgu fama ime si shkrimtar fitues i Çmimit Nobel. Marrë me shkurtime nga La Repubblica - Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

KOK-u fiton çmim për dokumentarin 'Kosova e Artë' në Kampionatin Botëror të Filmit Sportiv

PRISHTINË, 15 NËNTOR - Komiteti Olimpik i Kosovës ka fituar një nga çmimet që janë ndarë në edicionin e 40 të Kampionatit Botëror të Filmit Sportiv, të organizuar për pesë ditë në Milano të Italisë. KOK-ut iu dha çmimi "Mention D'Honneur" në kategorinë "Shpirti Olimpik". Dokumentari i dedikohet rrugëtimit të dy kampioneve tona olimpike "Tokio 2020",

xhudisteve Distria Krasniqi e Nora Gjakova. Çmimin, autorit të dokumentarit, Kushtrim Krasniqi, ia dha presidenti i Federatës Ndërkombëtare të Kinemasë Sportive Televizive (FICTS), Franco Ascani. Rreth 300 mysafirë ishin të pranishëm në ceremoni, mes tyre edhe personalitete të larta nga Komiteti Olimpik i Italisë, Ministria e Sportit të Italisë,

drejtues të Federatave Ndërkombëtare, medalistë olimpike, ish-futbollistë të mirënjohur, regjisorë, producentë etj. Me një videomesazh të pranishmit i përshëndeti edhe presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, Thomas Bach. 140 filma (dokumentarë) sportivë nga mbi 100 shtete kishin aplikuar për çmime.



Kosova sonte përballlet me Armeninë

Futbollistët "dardanë" janë përgatitur për miqësoren që zhvillohet sonte në stadiumin "Fadil Vokrri" ndaj Armenisë. Përzgjedhësi Alain Giresse ka thënë se kjo miqësore dhe tjera që zhvillohet pas tri ditësh ndaj Ishujve Faroe do t'i shërbejnë lojtarëve të rinj për të dëshmuar vetën, derisa Lindon Emërllahu beson se lojtarët e ftuar do të dëshmohen dhe do të fitojnë një vend në përfaqësuese edhe për ndeshjet zyrtare

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

Prishtinë, 15 nëntor - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll sonte (e mërkurë) zhvillon ndeshje miqësore me Armeninë nga ora 18:00 në stadiumin "Fadil Vokrri". Fillimisht nga "dardanët" në konferencë për medie të martën u paraqiten përzgjedhësi Alain Giresse dhe mesfushori Lindon Emërllahu, kurse po të njëjtën ditë u zhvillua edhe stërvitja e fundit para miqësorës ndaj armenëve. Përzgjedhësi Giresse duke folur për miqësore që zhvillon Kosova në këtë muaj, ka thënë se qëllimi i tij dhe stafit teknik ka qenë të ftohë lojtarët e rinj të cilët nëse dëshmohen mund të jenë pjesë e

përfaqësueses edhe në të ardhmen. "Siç e keni parë në listë përzgjedhja ishte që tu jepet hapësirë lojtarëve të rinj. Lojtarët në listë i njohim, por kjo do të jetë mundësi për ta dhe të shohim se si do të paraqiten. Kjo është ajo që desha të prezantojë dhe kjo ishte strategjia për t'i thirrur këta lojtarë të rinj", ka thënë Giresse. "Këto dy lojë jam i interesuar për lojtarët e rinj. Për ta është mundësi të tregojnë veten dhe pse jo që të ardhmen të jenë bazë të ekipit të Kosovës. Eksperienca nuk është e rëndësishme në këto lojë sa është e rëndësishme zbulimi i talentit dhe lojtarëve të rinj", ka shtuar Giresse. Në konferencë për medie foli edhe mesfushori i Ballkanit, Lindon Emërllahu, i cili



grumbullohet në Përfaqësuesen e Kosovës për herë të dytë në karrierën e tij. Mesfushori që tregoi formë të lartë me skuadrën kampione në këtë edicion, ka thënë se ndeshjet miqësore ndaj Armenisë dhe Ishujve Faroe janë një rast i mirë për lojtarët e rinj që të duhet të shfrytëzohen për të fituar një vend në ekipin

përfaqësues. "Jemi gjithë lojtarë të rinj në këtë grumbullim. Shpresojmë që të paraqitemi më mirë. Pse jo të ftohemi edhe në grumbullime të tjera. Shpresoj që në këto dy lojë të kam hapësirë për t'i treguar vlera e mia. Besoj që me paraqitjet me Ballkanit të më ndihmojnë dhe të paraqitem sa më mirë edhe te Kosova. Shpresoj

ta kem rastin dhe pse jo të tregoj vlerat e mia për të pasur mundësitë për të ardhmen", ka thënë Emërllahu. Ndeshja mes Kosovës dhe Armenisë zhvillohet nga ora 18:00 në stadiumin "Fadil Vokrri", kurse tri ditë me vonë po në të njëjtin stadium Kosova përballlet me Ishujve Faroe.

Të dielën fillon Liga e Veteranëve në basketboll



PRISHTINË, 15 NËNTOR - Të dielën do të fillojë Liga e Veteranëve të Kosovës dhe do të zhvillohet xhiroja e parë. Në Kampionatin për Veteranë do të marrin pjesë Trepça, Golden Eagle Ylli, Prishtina, Vëllaznimi, Peja dhe Bashkimi. Java e parë do të zhvillohet në Therandë, për të vazhduar më pas në qytete të tjera, ndërsa në tërësi do të zhvillohen pesë xhiro. Në klubet

përkatese do të luajnë ish-basketbollistë të njohur, që sërisht do të rikthehen në parket, kësaj radhe si veteranë. FBK-ja në kuadër të Planit Strategjik 2021-2025 e ka përfshirjen e gjithë komunitetit të basketbollit në aktivitetet e saj, ndërsa kohë më parë është formuar edhe Komisioni i Veteranëve të FBK-së. Me anë të këtij komisioni synohet që të

KAMPIONATI PËR VETERANË - XHIRO 1

Të dielën takohen:
14:00 Trepça - Golden Eagle Ylli
15:30 Prishtina - Vëllaznimi
17:00 Peja - Bashkimi

realizohen qëllimet e planit strategjik.

Vëllaznimi tërhiqet nga gara e Kupës, Prishtina kalon në të tetën e finales

PRISHTINË, 15 NËNTOR - FC Prishtina ka kaluar në të tetën e finales së Kupës së Kosovës në futboll pa luajtur fare. Në fakt, kryeqytetasit e bënë këtë përparim në këtë garë pas kërkesës së kundërshtarit të

tyre, Vëllaznimit, i cili nuk ka mundësi të paraqitet në lojë këtë të enjte për shkak se gjakovarët ndodhen në gjendje jo të mirë financiare. "Prishtina mbetet me shpresë se klubi 'kuqezi' do t'i tejkalojë

këto sfida dhe të organizohet pasi futbollit të Kosovës i duhen klubet me traditë siç është Vëllaznimi. Skuadra jonë pas vendimit për anulimin e ndeshjes, kalon në 1/8 e finales automatikisht",

ka njoftuar FC Prishtina në rrjetet sociale. Vëllaznimi ishte paraparë si kundërshtari i parë i Prishtinës për këtë edicion sa i përket Kupës, që është trofeu i dytë më i rëndësishëm në Kosovë.



Në mesjavë ndeshjet e rrethit të parë të Kupës në hendboll

Prishtinë, 15 nëntor - Në mesjavë, përkatësisht të mërkurën e të enjten, zhvillohen ndeshjet e rrethit të parë të Kupës së Republikës së Kosovës në hendboll. Ndeshjet luhen si për hendbollistë ashtu edhe për hendbolliste. Priten

ndeshje të mira, ndërsa nuk përjashtohet mundësia që të ketë ndonjë befasi. Te hendbollistët të mërkurën janë ndeshjet: Besa Famgas - Istogu (18:30), Prishtina - Lepenci (17:30), Trepça - Samadrexha (18:00), Rahoveci - Ulpiana (19:30), Kastrioti -

Drita (18:00), Deçani - Prizreni (19:00), Vushtrria - Llapi (18:00). Ndeshja e vetme që luhet të enjten është ajo në mes të Vëllaznimit dhe Vjosës (19:00). Te hendbollistët ndeshjet e të mërkurës janë: Prishtina -

Samadrexha (19:30), Kastrioti - Ulpiana (16:00), Shqiponja - Vjosa (16:00), Vëllaznimi - CLICK (18:30). Të enjten janë ndeshjet Istogu - Dukagjini (20:00), Ferizaj - Drita (17:00), Vushtrria - KEK-u (17:30). Të premtën është ndeshja Jusuf Gërvalla - Llapusha (18:00).



FIFA kërkon armëpushim në Ukrainë gjatë Kupës së Botës

CYRIH, 15 NËNTOR - Presidenti i Federatës Botërore të Futbollit (FIFA), Gianni Infantino, u bëri thirrje Rusisë dhe Ukrainës që të mbajnë armëpushim njëmuaj gjatë Kampionatit Botëror të Futbollit. Duke folur në samitin e grupit të vendeve më të industrializuara, G20, Infantino ka thënë se Kupa e Botës siguron një "platformë unike" për paqe dhe unitet, sepse ngjarja do të ndiqet nga rreth 5 miliardë njerëz në televizion. "Kështu që lutja ime për të gjithë ju është që të mbani armëpushim për një muaj, aq sa zgjat Kupa e Botës", ka thënë Infantino në Bali të Indonezisë. "Ju jeni udhëheqësit botërorë. Ju e keni aftësinë të ndikoni në rrjedhën e historisë", ka deklaruar ai.

Kupa e Botës nis të dielën në Katar. Ky vend është përbullur me kritika të mëdha për shkak të



shkeljeve të dyshuara të të drejtave të njeriut, sidomos të punëtorëve që kanë ndërtuar stadiumet.

Kreu i Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, Thomas Bach, u ka bërë thirrje vendeve që t'i dërgojnë atletët në Katar, bazuar në meritat e tyre sportive e jo në politikë. "Ne kemi nevojë për

pjesëmarrjen e të gjithë sportistëve që i pranojnë rregullat - edhe nëse vendet e tyre janë në konfrontim", ka thënë Bach.

Organizata të ndryshme sportive ndërkombëtare kanë vendosur sanksione ndaj Rusisë dhe atletëve të saj pas pushtimit të Ukrainës.

Bostoni merr frenat e NBA-së, fitojnë edhe Miami e Golden State

BOSTON, 15 NËNTOR - Skuadra e Milwaukee Bucksit humbet kreun në Konferencën e Lindjes, duke pësuar humbjen e tretë në pesë ndeshjet e fundit. Bucksit u mund me rezultat 121-106 në fushën e vet nga Atlanta. Të gjithë titullarët e Atlantës realizuan mbi 15 pikë, duke i bërë të pavlefshme 27 pikët e Antetokounmpos. Një fitore me përmbysje në sekondat e fundit arrin Miami, që mundi Phoenixin (113-112). Adebayo me 30 pikë e 10 rebounde ishte më i miri në fushë për Miamin. Fitore të lehtë korri ekipi kampion i Golden States, që mundi San Antonio (132-95), sfidë ku u dallua i riu Jordan Poole, autor i 36 pikëve për vendasit. Jashtë



fushës fiton skuadra kanadeze e Torontos, që mundi me rezultat 115-111 Detroitin, ndeshje ku Banton me 27 pikë bëri diferencën në parket. Nuk zhgënjën skuadra e Bostonit, që mundi me rezultat

126-122 Orlandon, duke marrë kreun e renditjes në Lindje dhe bëhet skuadra me më shumë fitore deri tani (11). Më të mirët për Celticsin ishin Tatum me 27 pikë e Browni me 26 pikë.

Rezultatet

Detroit - Toronto	111-115
Orlando - Charlotte	105-112
Boston - Oklahoma	126-122
Miami - Phoenix	113-112
Houston - Clippers	106-122
Milwaukee - Atlanta	106-121
Golden State - San Antonio	132-95

Buffoni: Në Botëror e përkrahi Kamerunin

Kampioni i Botës në vitin 2006, Gianluigi Buffon, ka thënë se në mungesë të Italisë është fans i Kamerunit në Botërorin e Katarit. "Si zakonisht, kur Italia

nuk është aty, përqipem që t'i ndjek skuadrat ku luajnë shokët e mi të skuadrës apo miqtë, apo ata të cilët tradicionalisht nuk janë

favoritë. Në këtë rast, kombi që do ta përkrah në Botëror është Kameruni. Ai ka një vend të veçantë në zemrën time", ka thënë Buffoni. Buffoni ka

vendosur që të jetë portier pasi kishte parë një ndeshje të Kamerunit në Botërorin e vitit 1990 dhe ishte inspiruar nga portieri i tyre, Thomas N'kono.

Ai i është shumë mirënjohës kësaj figure, madje ai e ka emëruar edhe djalin e tij, Thomas, për ta nderuar N'Konon.

SHKURT

Blerand Stavileci zgjedhet kryetar i përkohshëm i KB Prishtina

Ish-kryetari i Klubit të Basketbollit Sigal Prishtina, Blerand Stavileci, do të nisë një aventurë të dytë me kryeqytetasit. Sipas njoftimit të KB Prishtina, është mbajtur një mbledhje e jashtëzakonshme dhe aty është marrë vendim që Blerand Stavileci të zgjedhet ushtrues detyre i postit të kryetarit të klubit. "Në zyrat e klubit u mbajt mbledhje e jashtëzakonshme e Bordit të Klubit pas situatës së krijuar me rastin e dorëheqjes së presidentit Burim Maraj. Me propozim të 'Plisave', kryetarit të 'Plisave' në cilësinë e anëtarit të bordit, dhe me miratim unanim të të gjithë anëtarëve pjesëmarrës, u vendos që ushtrues detyre i kryetarit të klubit të zgjedhet Blerand Stavileci. Gjithashtu bordi i klubit votoi unanimisht për lirim nga detyra të menaxhmentit të klubit", thuhet në njoftimin e KB Prishtina.

Leclerc: Dua vendin e dytë në Abu Dhabi

Vendi i katërt në garën e fundit të Formulës 1, zhvilluar në Brazil, e ka rikthyer pilotin monogask të Ferrarit, Charles Leclerc, në vendin e dytë provizor për pilotë. Ai ka pikë të barabarta me meksikanin e Red Bullit, Sergio Perez, ndërkohë që gjithçka do të vendoset pas pesë ditësh në Abu Dhabi. Në garën e fundit Leclerc kërkoi nga skuadra që shoku i tij i skuadrës Carlos Sainz, që doli i treti, t'i hapë rrugën, por skuadra iu përgjigj negativisht, pasi mendonte se kjo mund të ndërlikonte garën e të dyve. "Gara ime në Brazil u kushtëzua nga ai aksident në start, që më çoi në fundin e renditjes. Rikuperova mjaft, dola i katërti, por tashmë është një sfidë mes meje dhe Perezit. Tashmë ka mbetur edhe një garë, ku do të vendoset gjithçka. Në Abu Dhabi do të bëj garën time, pa menduar për asgjë tjetër. Nëse unë renditem mirë edhe Ferrari do të qëndrojë i dyti në renditjen për skuadra", ka deklaruar Leclerc.

Ronaldo priset me Unitedin, 'filtron' me Bayernin

Në pritje të fakteve që klubi i Manchester Unitedit kërkon pas deklaratës "bombë" të bërë nga Cristiano Ronaldo, është thujse e sigurt se mes palëve nuk ka më kthim pas, divorci është thjesht çështje kohë dhe shifrash. Mediet britanike i kanë kushtuar faqen e parë çështjes "Ronaldo", të gjitha bashkohet në një pikë: United tani "shkarkon" Ronaldon, do t'i prish kontratën, ndërsa parashikohet edhe një supergjëbë. "Ti na tradhetoje", ishte titulli i "Mirror"-it. "Daily Mail" shkon edhe më tej duke shtuar se Ronaldo ka nisur prej kohësh të mendojë për një skuadër të re në janar, ndërsa në skenë del edhe një herë emri i Bayern Munchenit. Sipas të përditshmes britanike, Bayerni është prioriteti kryesor i portugezit, madje agjenti i tij Jorge Mendez ka nisur edhe një herë kontaktet me përfaqësuesin e Bayernit. "Asnjë shans për kthim pas", ishte titulli i "Daily Express" që, si të gjithë mediet e tjera, e bën të sigurt largimin e Ronaldos.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 32 dhe 33 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe nenit 6 paragrafët 3, 4, 5, 6, nenit 8 paragrafi 6 dhe neni 9 Rregullores Nr. 01/2022 për Përzgjedhjen dhe Përfundimin e Mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Përfundimit të Prokurorisë, Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 dhe Vendimit KPK/Nr.1267/2022 të datës 21 tetor 2022 të Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

V A Z H D I M I K O N K U R S I T

I. DREJTOR I PËRGJITHSHËM I SEKRETARIATIT TË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

REFERENCA	KPK/SKPK/NJSHP - 01
Emri Pozitës:	Drejtor i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës
Niveli:	I Lartë Drejtues
Raporton:	Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës
Paga:	Siç përcaktohet nga Këshilli
Numri i Pozitave:	Një (1) pozitë
Kohëzgjatja e kontratës:	Katër (4) vjet
Vendi:	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas dhe efektiv të administratës dhe Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Udhëheqë dhe përfaqëson Sekretariatit dhe është zyrtari më i lartë administrativ në sistemin prokurorial;

Drejtori është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas dhe efektiv të Sekretariatit dhe prokurorive. Drejtori i raporton Këshillit dhe Kryesuesit të Këshillit. Drejtori merr pjesë në të gjitha takimet e Këshillit dhe i përgjigjet të gjitha kërkesave të Këshillit për informacion; Përfaqëson Sekretariatit në raport me institucionet tjera publike, qeveritare dhe jo-qeveritare; Udhëheq dhe përfaqëson Sekretariatit dhe është zyrtari më i lartë administrativ në sistemin prokurorial;

Zbaton politikat dhe vendimet e Këshillit;

Përfaqëson Sekretariatit në raport me institucionet tjera publike, qeveritare dhe jo-qeveritare; Siguron menaxhimin dhe funksionimin efektiv të Sekretariatit dhe administrimin e prokurorive;

Planifikon personelin administrativ dhe mbështetës të Sekretariatit dhe prokurorive;

Bashkërendon aktivitetet në lidhje me përgatitjen e takimeve të Këshillit si dhe hartimin e mendimeve ligjore dhe planeve strategjike;

Mban kontaktet me institucionet e huaja në Kosovë, në kuadër të fushëveprimtarisë së tij;

Udhëheq me strukturën administrative të Sekretariatit dhe administratën e prokurorive, dhe Nxjerr vendime dhe akte tjera juridike për rregullimin e çështjeve të ndryshme që dalin nga fushëveprimi i tij;

Është përgjegjës ndaj kërkesave të Këshillit për informata dhe raporte nga fushëveprimtaria e tij.

Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:

Aftësi të larta organizative dhe Drejtuese duke veçuar ato të planifikimit dhe menaxhimit;

Aftësi për qasje pragmatike në gjetjen e zgjidhjeve me burime të kufizuara;

Aftësi për përcaktimin e prioritetëve;

Aftësi të larta komunikim dhe negociim e në hartim të akteve e shkresave;

Aftësi për të trajtuar informacion të besueshëm siç duhet;

Aftësi udhëheqëse, motivuese, komunikuese, menaxhim të performancës dhe aftësi për punë ekipore;

Njohuri të duhura për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;

Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga lëmi Juridik dhe administratës publike;

Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point, etj);

Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me ligjin për gjuhët.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare - Fakulteti Juridik, Jurist i Diplomuar dhe të ketë Provimin e Jurisprudencës.

Përvoja e Punës:

Të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë pune nga të cilat së paku katër (4) vite përvojë pune menaxhuese.

II. DREJTOR I NJËSITIT PËR SHQYRTIMIN E PERFORMANCËS SË PROKURORISË

REFERENCA	KPK/SKPK/NJSHP - 02
Emri Pozitës:	Drejtor i Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë
Niveli:	I Lartë Drejtues
Raporton:	Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës
Paga:	Siç përcaktohet nga Këshilli
Numri i Pozitave:	Një (1) pozitë
Kohëzgjatja e kontratës:	Katër (4) vite
Vendi:	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Drejtori është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas dhe efektiv të Njësitit për Shqyrtimin e Përfundimit të Prokurorisë.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas të Njësitit dhe i raporton drejtpërdrejtë Kryesuesit të Këshillit dhe iu përgjigjet të gjitha kërkesave të Këshillit për informata;

Ofron të dhëna statistikore për institucioneve dhe organizatave vendore në aspektin e statistikave dhe analizave;

Siguron zbatimin e vendimeve dhe politikave të Këshillit dhe Kryeprokurorit të Shtetit brenda fushëveprimit të NJSHP-së;

Është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm dhe për zbatimin e ligjshmërisë së punës brenda NJSHP-së;

Harton dhe zbaton planifikimin e punës së NJSHP-së në pajtim me politikat, strategjitë dhe planet e punës së Këshillit dhe Kryeprokurorit të Shtetit;

Mbikëqyrë procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave statistikore të punës së prokurorive, hartimin e raporteve dhe rekomandimeve;

Bashkërendon aktivitetet dhe bashkëpunon me Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit dhe njësitë e tjera brenda sistemit prokurorial dhe institucioneve të tjera në kuadër të fushëveprimtarisë së NJSHP-së;

Përgatitë raporte të rregullta periodike dhe sipas kërkesës së Këshillit, Prokurorit të Shtetit për punën e NJSHP-së;

Kryen edhe punë të tjera në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore të sistemit prokurorial.

Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:

Aftësi të larta organizative dhe Drejtuese duke veçuar ato të planifikimit dhe menaxhimit;

Aftësi për qasje pragmatike në gjetjen e zgjidhjeve me burime të kufizuara;

Aftësi për përcaktimin e prioritetëve;

Aftësi të larta komunikim dhe negociim e në hartim të akteve e shkresave;

Aftësi për të trajtuar informacion të besueshëm siç duhet;

Aftësi udhëheqëse, motivuese, komunikuese, menaxhim të performancës dhe aftësi për punë ekipore;

Njohuri të duhura për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;

Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga lëmi Juridik dhe administratës publike;

Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point, etj);

Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me ligjin për gjuhët.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare - Fakulteti Juridik, Jurist i Diplomuar dhe të ketë Provimin e Jurisprudencës.

Përvoja e Punës:

Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune nga të cilat së paku tri (3) vite përvojë pune menaxhuese.

Kushtet e përgjithshme:

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 2. Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me ligjin për gjuhët;
 3. Të mos jenë të dënuar për veprë penale;
 4. Të mos të kenë aktakuzë të ngritura ndaj tyre;
 5. Të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal dhe të mos kenë pasur masë të rëndë disiplinore të shqiptuar në pesë (5) vitet e fundit;
 6. Të ketë diplomë universitare, të jetë jurist i diplomuar dhe të ketë provimin e jurisprudencës
 7. Të ketë përvojë pune relevante prej shtatë (7) vite për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së, prej të cilave katër (4) vite përvojë menaxhuese, ndërsa për Drejtor të NJSHP-së të ketë përvojë punë prej pesë (5) vjetësh, prej të cilave tre (3) vite përvojë menaxhuese.
- Afati i konkursit zgjatet për dhjetë (10) ditë kalendarike, nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data **16.11.2022 deri me datë 25.11.2022**, si datë e mbylljes së konkursit.
 - Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org
 - Aplikimi në mënyrë elektronike: Pas plotësimit, aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet e skanuara të cilat kërkojnë sipas konkursit në formatin PDF, dokumentacioni dërgohet në postën elektronike: burimet.njerezore@rks-psh.org, ku me pas ju do të pranoni konfirmimin për dërgesën e aplikacionit tuaj në mënyrë elektronike.
 - Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerezore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
 - Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
 - Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.
 - **Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**
 - Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.
 - Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
 - Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."
 - **Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:**
 - Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, të bashkëngjitura në aplikacion, të nostrifikuar (për diplomat e marra jashtë vendi);
 - Kopjet e dëshmisë së përvojës së punës;
 - Referencat e ndryshme të punësimeve të mëparshme;
 - Certifikatën që nuk është në hetim dhe
 - Letër motivuese.
 - Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin në fuqi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Tužilački Savet Kosova na osnovu člana 32 i 33 Zakona Br.06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, Zakona Br. 03/L/-149 o Civilnoj Sluzbi Republike Kosova, člana 5 i 6 stav 3, 4, 5, 6 i član 8 stav 6 i 9 Pravilnik Br. 01/2022 o izboru i završavanju mandata Generalnog Direktora Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova i Direktora Jedinice za Razmatranje Performanse Tužilaštva, Rešenja sa br. Ref AGJ.1583/20 datuma 09 jula 2020 i Odluke TSK/Br.1267/2022 datuma 21 oktobar 2022 Tužilačkog Saveta Kosova, objavljuje sledeće:

P R O D U Ž E N J E K O N K U R S A

I. GENERALNI DIREKTOR SEKRETARIJATA TUŽILAČKOG SAVETA KOSOVA

REFERENCA	KPK/SKPK/NJSHP - 01
Naziv Pozicije:	Generalni Direktor Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova
Nivo:	Visoko Rukovodeći
Izveštava:	Predsedavajući Tužilačkog Saveta Kosova
Plata:	Kao što je Savet odredio
Broj Pozicija:	Jedna (1) pozicija
Trajanje ugovora:	Četiri (4) godine
Mesto:	Priština

Cilj radnog mesta:

Odgovoran je prema Savetu o efikasnom i efektivnom upravljanju administracije i Saveta i Državnog Tužioca.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Rukovodi i zastuplja Sekretarijat i najviši je administrativni službenik u tužilačkom sistemu; Direktor je odgovoran prema Savetu za efikasno i efektivno upravljanje Sekretarijata i tužilaštava. Direktor neposredno izveštava Predsedavajućem Saveta. Direktor ucesvuje u svim sednicama Saveta i odgovara na sve zahteve Saveta za informacijama; Rukovodi i Zastuplja Sekretarijat i najviši je administrativni službenik u tužilačkom sistemu; Sprovodi politike i odluke Saveta; Zastuplja Sekretarijat u odnosu na druge javne, vladine i nevladine institucije; Obezbeđuje efektivno upravljanje i funkcionisanje Sekretarijata i upravljanje tužilaštvima, Planira administrativno i pomoćno osoblje Sekretarijata i tužilaštva; Koordinira aktivnosti vezane za pripremu sednica Saveta kao i izradu pravnih mišljenja i strateških planova; Održava kontakte sa stranim institucijama na Kosovu, u okviru svog delokruga; Rukovodi administrativnom strukturom Sekretarijata i administracijom tužilaštava, i Izdaje odluke i druge pravne akte za regulisanje različitih pitanja koje proizlaze iz njegovog delokruga; Odgovoran je prema zahtevima Saveta za informacije i izveštaje iz njegovog delokruga;

Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Visoke organizacione i upravljačke sposobnosti, posebno one o planiranju i upravljanju; Sposobnost za pragmatični pristup u pronalaženju rešenja sa ograničenim resursima; Sposobnost određivanja prioriteta; Visoke komunikacijske i pregovaračke sposobnosti u izradi akata i dokumenata; Sposobnost pravilnog tretiranja pouzdanih informacija; Rukovodilačke, motivacijske, komunikativne veštine, upravljanje performanse i sposobnost za timski rad; Adekvatna znanja za efektivan nadzor stručnog rada obavljenog od strane podređenih; Odlično i sveobuhvatno stručno znanje iz oblasti prava i javne uprave; Dobro poznavanje i veštine rada sa računarnom pomoću programa (Microsoft Word, Excel, Power Point, itd). Poznavanje jenog od službenih jezika u skladu sa zakonom o jezicima

Profesionalna priprema i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma – Pravni Fakultet, Diplomirani Pravnik i da ima Pravodusni Ispit.

Radno iskustvo:

Da ima najmanje sedam (7) godina radnog iskustva od kojih najmanje četiri (4) godine radnog iskustva u rukovođenju.

II. DIREKTOR JEDINICE ZA RAZMATRANJE PERFORMANSE TUŽILAŠTVA

REFERENCA	KPK/SKPK/NJSHP - 02
Naziv Pozicije:	Direktor Jedinice za Razmatranje Performanse Tužilaštva
Nivo:	Visoki Rukovodeći
Izveštava:	Predsedavajući Tužilačkog Saveta Kosova
Plata:	Kao što je Savet odredio
Broj pozicija:	Jedna (1) pozicija
Trajanje ugovora:	Četiri (4) godine
Mesto:	Priština

Cilj radnog mesta:

Direktor je odgovoran prema savetu o efikasnom i efektivnom upravljanju Jedinice za Razmatranje Performanse Tužilaštva.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Odgovoran je prema Savetu za efikasno upravljanje Jedinice i direktno odgovara Predsedavajućem Saveta i odgovara na sve zahteve Saveta za informacijama. Pruža statističke podatke za lokalne institucije i organizacije u smislu statistike i analize;

Obezbeđuje sprovođenje odluka i politika Saveta i Glavnog Državnog Tužioca iz delokruga JRPT-a.

Odgovoran je za opšte rukovođenje i upravljanje i za sprovođenje zakonitosti rada u okviru JRPT-a.

Izradi i sprovodi planiranje rada JRPT-a u skladu sa politikama, strategijama i planovima rada Saveta i Glavnog Državnog Tužioca;

Nadgleda proces prikupljanja i obrade statističkih podataka o radu tužilaštava, izradu izveštaja i preporuka;

Koordinira aktivnosti i saraduje sa Generalnim Direktorom Sekretarijata i drugim jedinicama u unutar tužilačkog sistema i ostalim institucijama u okviru delokruga JRPT-a.

Priprema redovne periodične izveštaje, a prema zahtevu Saveta, Državnog Tužioca o radu JRPT-a.

Obavlja i druge poslove u skladu sa zakonom i podzakonskim aktima tužilačkog sistema.

Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Visoke organizacione i upravljačke sposobnosti, posebno one o planiranju i upravljanju; Sposobnost za pragmatični pristup u pronalaženju rešenja sa ograničenim resursima; Sposobnost određivanja prioriteta; Visoke komunikacijske i pregovaračke sposobnosti u izradi akata i dokumenata; Sposobnost pravilnog tretiranja pouzdanih informacija; Rukovodilačke, motivacijske, komunikativne veštine, upravljanje performanse i sposobnost za timski rad; Adekvatna znanja za efektivan nadzor stručnog rada obavljenog od strane podređenih; Odlično i sveobuhvatno stručno znanje iz oblasti prava i javne uprave; Dobro poznavanje i veštine rada sa računarnom pomoću programa (Microsoft Word, Excel, Power Point, itd). Poznavanje jenog od službenih jezika u skladu sa zakonom o jezicima.

Profesionalna priprema i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma – Pravni Fakultet, Diplomirani Pravnik i da ima Pravodusni Ispit.

Radno iskustvo:

Da ima najmanje pet (5) godina radnog iskustva od kojih najmanje tri (3) godine radnog iskustva u rukovođenju.

Opšti uslovi:

1. Da bude državljanin Republike Kosova;
 2. Poznavanje jednog službenog jezika u skladu sa zakonom o jezicima;
 3. Da ne bude kažnjen za krivično delo;
 4. Da nema podignute optužnice protiv njih;
 5. Da ima visoku profesionalnu reputaciju i lični integritet i da nemaju disciplinsku meru izričenu u poslednjih pet (5) godina;
 6. Da ima univerzitetsku diplomu, da bude diplomirani pravnik i da ima položen pravodusni ispit.
 7. Da ima odgovarajuće radno iskustvo od sedam (7) godina za poziciju Generalnog Direktora STSK-a, od kojih četiri (4) godine iskustva u rukovođenju, dok za Direktora JRPT-a da ima radno iskustvo od pet (5) godina, od kojih tri (3) godine iskustva u rukovođenju.
- Konkursni rok se produžava za deset (10) kalendarskih dana, u dana objavljivanja u službenoj stranici Tužilačkog Sistema Republike Kosova, kao i u dnevnim novinama, počevši od **16.11.2022 do 25.11.2022** kao datum kada se konkurs završava.
 - Zahtev (aplikacija) za zapošljavanje nalazi se na veb stranicu: www.prokuroria-rks.org
 - Apliciranje elektronskom formom: Nakon popunjavanja, aplikaciji priložite skenirane dokumente koje se traže konkursom u formatu PDF, dokumentacija žalje se elektronskom poštom: burimet.njerezore@rks-psh.org, gde ćete zatim dobiti konfirmaciju za dostavljanje vaše aplikacije elektronskim putem.
 - Apliciranje putem pošte: Kompletirane zahteve sa dokumentacijom možete dostaviti i putem pošte u Diviziji za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Ulica "Luan Haradinaj", br. 100, Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.
 - Aplikacije dostavljene putem pošte koje sadrže pečat pošte o dostavljanju poslednjeg dana roka za apliciranje, smatrarće se važećim i uzimaće se na razmatranje, ako stignu u roku od 4 dana, aplikacije koje stignu nakon ovog roka i one nekompletirane neće biti uopšte razmatrane.
 - Po potrebi možete nas kontaktirati na tel: 038/200 18874 od 08:00 – 16:00.
 - Uslovi učesća na konkursu:
 - Pravo na apliciranje imaju svi punoletni građani Republike Kosova koji imaju potpunu sposobnost delovanja, koji su u potpunim građanskim i političkim pravima, imaju potrebnu obrazovnu pripremu i profesionalnu sposobnost za vršenje dužnosti i koji imaju fizičke sposobnosti koje se traže za odgovarajuću poziciju.
 - Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža ravnopravne mogućnosti za sve državljane Kosova i očekuje aplikacije od svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu.
 - "Ne većinska zajednica i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe javne centralne i lokane uprave kao što je specifikovano članom 11 stav 3 Zakona Br.03/L-149 o Civilnoj Sluzbi Republike Kosova."
 - Aplikaciji treba se priložiti skenirane kopije tražene dokumentacije:
 - Kopije diploma izdate od strane obrazovnih institucija, priloženo uz aplikaciju, nostrifikovane (za diplome koje su stečene van zemlje);
 - Kopije dokaza o radnom iskustvu;
 - Razne referense predhodnih zapošljavanja;
 - Sertifikat da nije pod istragom i
 - Pismo motivacije.
 - U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove predviđene na osnovu ovog konkursa, kandidati biće upozantni na osnovu pravodusnog zakona.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1656/1
Dt: 15.11.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

RI-SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendit të lirë në Qendër e Kompetencës në Malishevë për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
QeK	Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë	Malishevë	Një mësimdhënës/e për lëndët e matematikës me 20 orë mësimore	Vend i lirë
QeK	Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë	Malishevë	Një mësimdhënës/e për lëndën profilin Instalues elektrikë me 20 orë mësimore	Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Procedurat e konkurrimit:

- Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e publikimit. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "Kujtim Krasniqi", në Malishevë.
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Njoftim për mbrojtje publike të Punimit të Doktoratës

Njoftohen të gjithë të interesuarit se me datë 24.11.2022 (e enjte), prej orës 12:00, në Fakultetin Ekonomik (salla e profesorëve), kandidatja Msc. Luljeta Glogjani i nënshtrohet mbrojtjes publike të Punimit të Doktoratës me temën: "Politika Fiskale dhe Rritja Ekonomike në Vendet në Tranzicion të Evropës Juglindore", me mentor Prof.Asoc.Dr. Driton Balaj, para komisionit profesional, në përbërje prej:

Prof. Dr. Safet Merovci- kryetar i komisionit,
Prof.Asoc. Dr. Nimete Berisha- anëtare e komisionit,
Prof. Dr. Seadin Xhaferi - anëtarë i jashtëm i komisionit (Fakulteti Ekonomik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Maqedoni Veriore).

Njoftim për zvogëlim kapitali

Pronarët e biznesit "Z Zanafilla Sun" SHPK me numër Unik identifikues: 811966590, Shefket Elezi dhe Zejnë Shehu kanë vendosur të bëjnë zvogëlim e kapitalit themelues nga 50.000.000 € euro në kapitalin e ri 1.000.000.

Shpallja vlen 30 ditë nga data e shpalljes.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shpresim Mazllami shpall te pavlefshme dëftesën e kl I - VIII shfmu "Leke Dukagjini" Prizren.

- Nuhi Mazreki shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Leke Dukagjini" Prizren.

- Ali Pervizaj shpall te pavlefshme dëftesën e kl I - V shfmu "Mit'hat Frasher" Krajk.

- "Meli Farm" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330493859.

- Donika Lleshaj nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e maturës të lëshuar nga Gjimnazi "Hajdar Dushi".

- Skender Idriqi B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 810360371.

- Ganimete Zejnullahu shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Ulpiana" Lipjan.

- Makfire Etemi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Ali Sokoli" Prishtinë.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

